

Fjalë drejtuar burrave (5:25–33)

Pasi i udhëzon gratë të jenë të nënshtruara ndaj burrave të tyre (5:22), Pali u drejtohet burrave duke i inkurajuar ata që t'i duan gratë e tyre dhe t'u plotësojnë nevojat. Për çfarë ka nevojë një grua në të vërtetë? Vini re përgjigjen e mëposhtme:

Çfarë duan më shumë gratë në marrëdhëniet me burrat? Mundësi të barabarta në punë? Dinjitet në shtëpi? Pothuajse asnjë në botën perëndimore në fillim të shekullit XXI nuk do të sugjeronte se duhet të jetë ndryshe.... Megjithatë, për shumë gra, ndërsa të drejtat e tyre afirmohen dhe shkallët e karrierës për të shkojnë lart e më lart në fusha nga më të ndryshmet, dëshira e papërmbajtur për afirmim, si në shtëpi ashtu edhe në vendin e punës, i braktis ato. Karriera shpesh nuk u sjell kënaqësi. Jeta familjare dhe martesore nuk është ashtu si e mendonin. Pavarësisht se si është marrëdhënia e tyre e përditshme me burrat, shumë gra e ndiejnë se diçka e rëndësishme, diçka themelore mungon në jetën e tyre.

Po t'i pyesje, pak gra (dhe, në të vërtetë, pak burra) do të mund ta kuptonin se cili ishte problemi. Në këto vite që jetojmë, të gjithë mendojmë kaq larg së vërtetës, Fjalës së Perëndisë.... Kush do të mund ta mendonte ndonjëherë se ajo për çfarë kanë më shumë nevojë gratë është udhëheqja shpirtërore e meshkujve? Shumë pak gra e dinë këtë.

Te Efesianëve 5:25–33 nuk gjenden fjalët «udhëheqja shpirtërore e meshkujve», por kjo është ajo për të cilën flet Pali në këto vargje. Ashtu si gruaja tregon nënshtrim ndaj Perëndisë kur ndjek kryesinë e burrit, ashtu edhe burri tregon nënshtrim ndaj Perëndisë kur e ushtron kryesimin e tij si

duhet.

Një burrë drejton si duhet kur e merr seriozisht këtë urdhërim: «Ju, burra, t'i doni gratë tuaja» (5:25a). Ky varg përkufizon udhëheqjen shpirtërore të meshkujve. Ai thotë se burri duhet të jetë i dashur dhe i kujdesshëm në marrëdhëniet me gruan e tij, dhe jo thjesht «bosi» i saj.

Lexoni udhëzimet e Palit për burrat:

Ju, burra, t'i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të, që ta shenjtërojë, pasi e pastroi me larjen e ujit me anë të fjalës, që ta nxjerrë atë pëpara vetes të lavdishme, pa njolla a rrudha a ndonjë gjë të tillë, por që të jetë e shenjtë dhe e paqortueshme. Kështu burrat duhet t'i duan gratë e veta porsì trupat e tyre; kush do gruan e vet do vetveten.

Sepse askush nuk urreu mishin e vet, por e ushqen dhe kujdeset me butësi për të, sikurse edhe Zoti bën me kishën, sepse ne jemi gjymtyrë të trupit të tij, të mishit të tij dhe të kockave të tij. «Prandaj njeriu do të lërë babanë e vet dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet, dhe të dy do të bëhen një mish i vetëm». Ky mister është i madh; tani unë e them në lidhjen me Krishtin dhe me kishën. Por secili nga ju kështu ta dojë gruan e vet sikurse e do veten e vet; dhe po kështu gruaja ta respektojë burrin (5:25–33).

Fjalët e Palit na mësojnë këtë të vërtetë themelore: *Një burrë kristian e tregon dedikimin e tij ndaj Krishtit, kur e përdor rolin e tij drejtues në familje për t'u kujdesur me butësi për gruan e tij.*

KUJDESI I VËRTETË

Çfarë do të thotë të jesh bashkëshort? Do të

thotë të jesh drejtues i dashur. Te vargu 25 thuhet: «Ju, burra, t'i doni gratë tuaja,...» Duket e thjeshtë, apo jo? Vështirësia qëndron në atë se si e përdorim fjalën «dashuri» sot. «Dashuria» shpesh është e kushtëzuar. Për disa, dashuria është ta trajtosh mirë gruan për sa kohë që është e re dhe e bukur. Për të tjerë, dashuria do të thotë të jesh i mirë me të për sa kohë ajo është e mirë me ty, të jesh i mirë me të për hatër të fëmijëve apo të kujdesesh për të në shkëmbim të përpjekjeve të saj për të mbajtur shtëpinë dhe për të rritur fëmijët.

Pali nuk na lejon që të vendosim kushte për dashurinë. Pali na dha dy krahasime për të na ndihmuar të kuptojmë se çfarë kishte në mendje.

Krahasimi i parë i Palit shpreh në mënyrë të thjeshtë: «Ju, burra, t'i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të» (5:25). Pali e krahason marrëdhënien e burrit me gruan e tij me marrëdhënien midis Krishtit dhe kishës së Tij. Ky është një krahasim i fuqishëm. Gjatë gjithë letrës së Efesianëve Pali thekson bashkimin jetësor midis Krishtit dhe kishës. Krishti është kreu i kishës (1:22, 4:15). Krishti e do kishën dhe e ka dhënë veten e Tij për të (3:19, 5:2). Krishti i solli kishës shpëtimin me anë të vdekjes së Tij (1:7, 13, 2:5–6, 2:14–18). Ai kujdeset për nevojat dhe rritjen e kishës së Tij (4:11–16). Ai banon në zemrat e atyre që i përkasin kishës së Tij (3:17). Krishti gjithashtu kujdeset për rritjen dhe mirëqënien e kishës së Tij (4:15–16).

Pasi i thotë të gjitha këto, në kapitullin 5 Pali e jep marrëdhënien e pabesueshme midis Krishtit dhe kishës së Tij si model të dashurisë që një burrë duhet të ketë për gruan e tij. Fakti që Pali mori guximin të përdorë një shembull të tillë tregon se sa rëndësi i jepte ai mënyrës se si ne, burrat, duhet të sillemi me gratë tona.

Në kapitullin 5, Pali dha një përshkrim të detajuar të dashurisë së Krishtit për kishën. Në këtë kapitull ndiejmë *plotësinë* e dashurisë së Krishtit.

Së pari, Krishti e deshi kishën. Kjo na çon në të kaluarën e përjetshme. Krishti e deshi kishën që para krijimit. Edhe kur kisha ishte vetëm një ide në mendjen e Perëndisë, Krishti e deshi atë.

Së dyti, Krishti e dha veten e tij për të. Ai la qiellin, erdhi në tokë, u bë njeri dhe vdiq për t'i sjellë jetë kishës. Ai nuk mbajti asgjë. Ai u dha i gjithi.

Së treti, Krishti e pastroi kishën me anë të

Fjalës në pagëzim. Pali e dinte këtë nga përvoja e tij vetjake. Kur ishte mëkatar, para se të bëhej anëtar i kishës së Krishtit, atij iu tha se çfarë duhej të bënte, që të shpëtohej dhe t'i shtohet kishës. Ai dëgjoi këto fjalë: «Çohu dhe ji i pagëzuar dhe i larë nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit» (Veprat 22:16). Një pjesë e asaj që i veçon kishat e Krishtit nga sektet fetare është ky besim: Kur dikush vjen të pagëzohet në ujë duke pasur besim në Fjalën e Perëndisë, ai pastrohet shpirtërisht, jo me anë të ujit fizik, por me anë të fuqisë së Krishtit. Krishti e pastron kishën e Tij.

Së katërti, Krishti e tregon dashurinë për kishën në përpjekjet e Tij për ta bërë atë të shenjtë. Krishti do që ta bëjë kishën të shenjtë, në karakter dhe sjellje: «...që të jetë e shenjtë dhe e paqortueshme» (5:27).

Së fundi, Krishti e do kishën dhe, në mbarim të kohës, Ai do ta nxjerrë atë të lavdishme përpara Vetes. Fjala «lavdi» në Bibël i referohet rrezatimit të shkëlqyeshëm dhe të dukshëm të karakterit të Perëndisë. Një ditë dashuria e Krishtit do t'i sjellë kishës së Tij bukuri rrezatuese dhe të perëndishme. Gjoni, një apostull tjetër, na dha një pamje se si do të jetë:

Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar, dhe deti nuk ishte më. Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jeruzalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolitur për burrin e vet (Zbulesa 21:1–2).

Njeriu nuk mund ta kuptojë kurrë se sa e madhe është dashuria e Krishtit për kishën e Tij. Do të ishte më e lehtë për ne të numëronim me saktësi kokrrizat e rërës në të gjitha plazhet e botës se sa të masnim dashurinë e Krishtit për kishën e Tij. Dashuria e Tij shtrihet nga e kaluara e përjetshme deri sot dhe nga sot deri në të ardhmen e përjetshme.

Çfarë bëjmë me këtë dashuri të jashtëzakonshme? Burra, duhet ta lëmë atë të na bëjë të gjunjëzohemi. Duhet ta lëmë atë të largojë prej nesh krenarinë e shëmtuar që nuk i lejon martesat tona të jenë ashtu siç i do Perëndia. Duhet ta lëmë atë të largojë prej nesh egoizmin që na pengon t'u shërbejmë grave tona.

Krishti na tregon ne burrave se gratë tona kanë nevojë për një drejtues që shërben. Gratë kanë nevojë për dikë që t'i dojë, për dikë që jep, në vend që të marrë gjithmonë. Ato kanë nevojë për dikë që

kërkon të nxjerrë në dukje më të mirën në to dhe që dëshiron që gratë të bëhen çfarë Perëndia ka në mendje për to si fëmijë të Tij.

Ç'DO TË THOTË TË KUJDESESH PËR BASHKSHORTEN?

Pali jep edhe një krahasim të dytë për të na ndihmuar të kuptojmë dashurinë që duhet të kemi për gratë tona. Ky krahasim vjen nga jeta jonë: «Kështu burrat duhet t'i duan gratë e veta porsit trupat e tyre; kush do gruan e vet do vetveten. Sepse askush nuk urreu mishin e vet, por e ushqen dhe kujdeset me butësi për të» (5:28–29a). Në qoftë se ka ndonjë gjë që e kuptoj, kjo është kujdesi për veten time. Kur kam uri, e ushqej veten. Kur lodhem, pushoj. Kur kam dhimbje, bëj ç'është e mundur që ta lehtësoj atë.

Martesa është e mrekullueshme, sepse, ndërsa jemi një mish i vetëm, kur e dua gruan time, në të njëjtën kohë tregoj dashuri dhe ndaj vetes sime. Kujdesi për të është kujdes edhe për veten time gjithashtu.

Çfarë duhet të bëjnë burrat për bashkshortet e tyre? Lista e mëposhtme mund të shërbejë si një fillim i mirë.

Dedikojini asaj një pjesë të mirë të kohës suaj...ajo ka përparësinë numër një;
Jepini asaj praninë tuaj...praninë fizike si edhe atë emocionale;
Jepini të vërtetën...mbani rolin e drejtuesit shpirtëror në shtëpi, duke u siguruar se gruaja dhe familja juaj po mësojnë të vërtetën;
Jepini dashuri...për të plotësuar nevojat e saj;
Lutjuni...Atit t'ju ndihmojë të kujdeseni për të;
Faleni...për të përmirësuar marrëdhënien tuaj;
Drejtojeni...atë dhe shtëpinë tuaj;
Jepini trashëgiminë tuaj...duke ndarë me të gjithëçka që keni.

SI DUHET SHPREHUR KUJDESI PËR BASHKSHORTEN NË PRAKTIKË?

Fjala e Perëndisë drejtuar grave është «nënshtrohuni» (5:22). Fjala e Perëndisë drejtuar burrave është «doni» (5:25). Le ta bëjmë më praktike këtë. Mbani parasysh dashurinë që keni për gruan tuaj. Le të bëjmë testin e mëposhtëm duke dhënë për çdo fjali një vlerësim nga 1 te 10, ku 1 është «asnjëherë nuk e bëj një gjë të tillë» dhe 10 është «gjithmonë e bëj një gjë të tillë».

- _____ «Kurrë nuk e braktis gruan time»
- _____ «Kujdesem më shumë për gruan time se sa

për veten.»

- _____ «Kurrë nuk pres të më japë më shumë se sa mundet të japë.»
- _____ «Kurrë nuk kërkoj të jem «bosi» në shtëpi.»
- _____ «Krenaria ime nuk shkakton kurrë probleme në martesëm tonë.»
- _____ «Nuk e detyroj që t'i bëjë gjërat si them unë.»
- _____ «Kur jam me të, kurrë nuk them: «Jam unë i pari».»
- _____ «Kurrë nuk zemërohem (sillem) keq me të.»
- _____ «Nuk i numëroj kurrë gabimet e saj.»
- _____ «E fal kur e ka gabim.»
- _____ «Kënaqem kur e shikoj që ajo rritet shpirtërisht.»
- _____ «Do të jem mbështetje për të gjithmonë për çdo gjë.»
- _____ «Do të kem besim te plani i Perëndisë për jetën e saj.»
- _____ «Gjithmonë do mendoj më të mirën për të.»
- _____ «Kurrë nuk do të ndërroj mendje për premtimin që i bëra kur u martuam.»
- _____ «Do ta mbaj premtimin për ta ndihmuar që ajo të bëhet ashtu si e do Perëndia.»
- _____ «Dashuria ime për të s'do të shterojë kurrë.»

KONKLUZION

Burra, Perëndia nuk pret që ju të jeni të përkryer, por Ai pret nga ju që të jepni ç'është e mundur për të treguar dashurinë dhe kujdesin që gratë tuaja kanë nevojë të marrin prej jush.

Kthehuni nga Jezusi. Ai është i gatshëm t'ju ndihmojë. Pse nuk merrni përsëri vendimin që të jeni një bashkeshort i mirë ashtu si do Perëndia. Perëndia do ta mbajë premtimin që t'ju forcojë dhe t'ju ndihmojë për të bërë realitet një gjë të tillë.

«Ju, burra, t'i doni gratë tuaja,...»



Martesa

«Sa më afër Krishtit të jenë një burrë e një grua, aq më qartë e shikojnë se sa e rëndësishme është që të qëndrojnë pranë njëri-tjetrit.»

Richard D. Dobbins

Në ditën e përvjetorit të pesëdhjetë të martesës së tij, dikush e pyeti Henri Fordin: «Cila është formula për një martesë të mirë?» Ai u përgjigj: «Është e njëjta formulë që përdoret për një makinë të mirë. Mbaj gjithmonë të njëjtin model.»